Syllabus për lëndën KONTABILITETI FORENZIK

| TË DHËNA BAZIKE TË LËNDËS | |
|---|---|
| **Njësia akademike:** | Fakulteti Ekonomik – Universiteti i Prishtinës |
| **Titulli i lëndës:** | Kontabiliteti Forenzik |
| **Niveli:** | Bachelor |
| **Statusi lëndës:** | Zgjedhore |
| **Viti i studimeve:** | Semestri VI (viti III-të) |
| **Numri i orëve në javë:** | 2+1 |
| **Vlera në kredi – ECTS:** | 4 |
| **Koha / lokacioni:** | |
| **Mësimëdhënësi i lëndës:** | Dr. Sead Ujkani |
| **Detajet kontaktuese:** | sead.ujkani@uni-pr.edu |
| | |
| **Përshkrimi i lëndës** | Përmes lëndës studentët do të njihen me konceptet dhe praktikat e kontabilitetit forenzik. Lënda është dizajnuar për të ofruar njohuri për mjedisin etik, ligjor dhe përgjegjësitë e një kontabilisti forenzik. Hetimi i mashtrimit, format dhe elementet e mashtrimeve, si dhe zbulimi dhe parandalimi i mashtrimit janë pjesë thelbësore e lëndës.<br><br>Lënda ofron një bazë solide për ndërtimin e aftësive në teknikat e kontabilitetit forenzik, duke përfshirë mbledhjen, interpretimin dhe dokumentimin e provave. Në këtë lëndë ne shqyrtojmë teknikat hetimore të përdorura nga kontabilistët për të kryer ekzaminime forenzike, si dhe skemat dhe teknikat e zakonshme të përdorura për të kryer mashtrime. Aftësitë e fituara do t'ju mundësojnë të ndihmoni bizneset në zbulimin, hetimin, dokumentimin dhe parandalimin e mashtrimit. |
| **Qëllimet e lëndës:** | Qëllimi kryesor i lëndës është që studentët të kuptojnë konceptet dhe metodat themelore të kontabilitetit forenzik, si dhe të zhvillojë aftësitë dhe ekspertizën e duhur për të aplikimin e tyre në praktikë. |

| | |
|---|---|
| **Rezultatet e pritura të nxënies:** | Pas përfundimit të kësaj lënde studentët do të jenë në gjendje të:<br>- Kuptojë mjedisin etik, ligjor dhe përgjegjësitë e një kontabilisti forenzik;<br>- Demonstrojnë njohuri thelbësore forenzike;<br>- Analizojnë dhe diskutojnë konceptet dhe praktikat kontabilitetit forenzik<br>- Analizojnë dhe identifikojnë veprimet e duhura të cilat do të ndërmerren nga një kontabilist i forenzikës, duke përfshirë procedurat e zbulimit të mashtrimit;<br>- Demonstrojnë një kuptim të qartë të metodave të përbashkëta të teknikave të zbulimit të mashtrimit të pasqyrave financiare;<br>- Demonstrojnë aftësitë për zhvillimin e hetimit të mashtrimit, rolet dhe përgjegjësitë e palëve të ndryshme;<br>- Demonstrojnë një kuptim bazik të kontabilitetit forenzik dixhital. |

**Kontributi në ngarkesën e studentit**

| Aktiviteti | Orë | Ditë/javë | Gjithsej |
|---|---|---|---|
| Ligjërata | 2 | 15 | 30 |
| Ushtrime teorike/laboratorike | 1 | 15 | 15 |
| Punë praktike | | | |
| Kontaktet me mësimdhënësin / konsultimet | 1 | 15 | 15 |
| Ushtrime në teren | | | |
| Kollokfiume,seminare | 1 | 2 | 2 |
| Detyra të shtëpisë | | | |
| Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi) | 2 | 15 | 30 |
| Përgatitja përfundimtare për provim | 1 | 4 | 4 |
| Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final) | 1 | 4 | 4 |
| Totali | | | **100 orë** |

| | |
|---|---|
| **Metodologjia e mësimëdhënies:** | Sipas orarit të përcaktuar të ligjëratës, mësimdhënia do të zhvillohet përmes shpjegimit teorik të materialit mësimor, detyrave praktike, analizës dhe diskutimeve të rasteve studimore, si dhe punimeve individuale apo edhe grupore për kontabilitetin forenzik.<br>Detyrat praktike, analiza dhe diskutimi i rasteve studimore, si dhe përgatitja e punimeve, u mundësojnë studentëve të zhvillojnë kompetencën e tyre për kontabilitetin forenzik, si dhe duke zhvilluar më tej aftësitë e tyre të komunikimit dhe të menduarit kritik.<br>Njëkohësisht, studentët duhet të jenë në gjendje të demonstrojnë aftësitë e tyre, që realizohet duke përfunduar me sukses detyrat e caktuara, punimin, aktivitetin gjatë orës mësimore, vlerësimet periodike, si dhe përmes provimit.<br>Çdo student duhet të lexojë materialin përpara ligjëratës, të kryejë detyrat e caktuara pas ligjëratës dhe të jetë i përgatitur për t'i diskutuar ato në ligjëratën vijuese.<br>Pra, studentët duhet të jenë të përgatitur për të marrë pjesë në diskutimet gjatë ligjëratës, për t'iu përgjigjur pyetjeve dhe për të zgjidhur detyrat e caktuara.<br>Ligjëratat teorike, detyrat praktike dhe materialet tjera mësimore do të ofrohen përmes shfrytëzimit të platformave të teknologjisë informative, si dhe do të publikohen në SEMS apo edhe në klasën virtuale  të krijuar në platformën Google Classroom. |
| **Metodat e vlerësimit:** | Vlerësimi bazohet në pikët kumulative të fituara gjatë semestrit. Pikët fitohen nga testet periodike, detyrat, punimi dhe pjesëmarrja në diskutime gjatë ligjëratës.<br><br>Vlerësimi i studentëve konsiston në:<br><br>- Testi i parë 40 pikë<br>- Testi i dytë 40 pikë<br>- Pjesëmarrja & Angazhimi në diskutimet gjatë orës dhe rastet  studimore që trajtohen 40 pikë<br>- Detyra, punimi 10 pikë<br>____________________<br>Gjithsej:  100  pikë |

| LITERATURA | |
|---|---|
| **Literatura bazë:** | - Forensic Accounting, 1st edition, ISBN 978-0-13-305047-9, Robert J. Rufus, Laura Savory Miller, William Hahn, Pearson Education © 2015.<br>- Materialet e përgatitura për ligjërata, rastet e studimit, detyrat praktike,si dhe projekti. |
| **Literatura shtesë:** | - Essentials of Forensic Accounting, ISBN: 978-1-94165-110-0, Michael A. Crain, William S. Hopwood, Carl Pacini, George R. Young, American Institute of Certified Public Accountants, Inc., 2015.<br>- Fraud Examination, 6th Edition. W. Steve Albrecht, Chad O. Albrecht, Conan C. Albrecht, and Mark F. Zimbelman. Cengage Learning. 2019.<br>- A guide to forensic accounting investigation / Thomas W. Golden, Steven L. Skalak, and Mona M. Clayton.<br>- Materiali i trajnimit "Ekspert i licensuar i forenzikës financiare", Dr. Sandra Damijan, ShKÇAK. |

| PLANI I DIZEJNUAR I MËSIMIT | |
|---|---|
| Java | Ligjërata që do të zhvillohet |
| *Java e parë:* | Prezantim i lëndës dhe hyrje në kontabilitetin forenzik |
| *Java e dytë:* | Përkufizimi dhe zhvillimi i kontabilitetit forenzik |
| *Java e tretë*: | Mjedisi ligjor i kontabilitetit forenzik |
| *Java e katërt:* | Hetimi i mashtrimit, elementet e mashtrimeve |
| *Java e pestë:* | Psikologjia e mashtruesit |
| *Java e gjashtë*: | Teknikat e zbulimit të mashtrimit |
| *Java e shtatë:* | Anomalitë në kontabilitet dhe dobësitë në kontrollin e brendshëm |
| *Java e tetë:* | Procesi i hetimit, planifikimi i hetimit, metodat hetuese |
| *Java e nëntë:* | Testi 1 |
| *Java e dhjetë:* | Sigurimi dhe vlerësimi i provave financiare dhe jo-financiare |
| *Java e njëmbëdhjetë*: | Transaksionet financiare dhe skemat e mashtrimit |
| *Java e dymbëdhjetë*: | Raportimi financiar mashtrues, Zbulimi i mashtrimit në raportimin |
| *Java e trembëdhjetë*: | Kontabiliteti forenzik në mjedise digjitale |
| *Java e katërmbëdhjetë*: | Raporti mbi mashtrimin, Standardet e raportimit dhe gabimet që duhet shmangur gjatë raportimit |
| *Java e pesëmbëdhjetë*: | Testi final |

| POLITIKAT AKADEMIKE DHE RREGULLAT E MIRËSJELLJES |
|---|
| Pjesëmarrja në ligjërata dhe ushtrime është e detyrueshme. Studentët pritet të ndjekin standarde të larta të sjelljes, duke demonstruar sjellje të respektueshme, të përgjegjshme dhe të përshtatshme në çdo situatë. Çdo gjuhë apo sjellje e papërshtatshme ose joprofesionale nuk do të tolerohet. Gjithashtu, studentët duhet të respektojnë orarin, të ruajnë disiplinën gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve, si dhe t'i përmbahen kodit të etikës gjatë ligjëratave, ushtrimeve dhe testit/provimit. |